

PROJEKTI I RRJETEVE TË ZMD

*Mbështetje e efektivitetit të ZMD përmes rrjeteve të fuqishme dhe bashkëpunuese në Mesdhe
Aktivitete pilote në Shqipëri “Menaxhimi i peshkimit të qëndrueshëm artizanal dhe atij rekreativ në ZMD
Karaburun - Sazan”*

NJOFTIM PËR SHTYP

Tavolinë e rrumbullakët diskutimi “Rekomandimet për përmirësime në kuadrin ligjor dhe rregullator për peshkimin artizanal dhe argëtues në gjirin e Vlorës”

Qendra e Vizitorëve Radhimë, datë 10.06.2021 ora 11:00

Aktiviteti i peshkimit dhe veçanërisht atij artizanal dhe rekreativ pranë zonave të mbrojtura detare, mbetet një çështje që kërkon gjithmonë e më tepër bashkëpunimin mes aktorëve lokalë.

Projekti i BE-së “MPA NETWORKS - Mbështetje e efektivitetit të Zonave të Mbrojtura Detare (ZMD) përmes rrjeteve të fuqishme dhe bashkëpunuese në Mesdhe”, me bashkëfinancim nga Fondi Evropian për Zhvillimin Rajonal në kuadrin e programit Interreg Med, i cili ka nisur nga zbatimi prej një viti në rajonin e Vlorës, përfshirë Parkun Kombëtar Detar Karaburun-Sazan (PKDKS), ka sjellë në vëmendje disa praktika pozitive që synojnë bashkëpunimin mes të gjithë aktorëve publik dhe jo publik, me qëllim përfitimim si në aspektin e mirëmenaxhimit të një zone të mbrojtur detare, ashtu edhe të zhvillimit të qëndrueshëm të peshkimit artizanal, duke ndikuar pozitivisht edhe në impaktin socio-ekonomik të komunitetit të peshkatarëve që jetojnë pranë ZMD.

“Pasioni dhe nevoja është ajo që e bën një peshkatar të vazhdojë të punojë, por nevoja për mbështetje, ligj funksional, kontroll të peshkimit industrial dhe sportiv janë element kyç për mbarëvajtjen e punës sonë”- shprehet një peshkatar.

Në këtë kuadër Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) në bashkëpunim me AdRZM Vlorë dhe organizata të shoqërisë civile lokale si Flag Pine, ashtu, si dhe vetë komunitetin e peshkatarëve, ka nxitur takime dhe përballje të aktoreve, duke e vlerësuar si një domosdoshmëri pjesëmarrjen më të gjerë të institucioneve shtetërore në dëgjuesat me peshkatarët dhe po ashtu edhe një bashkëpunim më të madh midis tyre me qëllim propozimin e politikave përmirësuese dhe hartimin e dokumentacioneve rregullatore në funksion të zhvillimit të një peshkimi të qëndrueshëm artizanal dhe rekreativ pranë një zone të mbrojtur detare siç është Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan.

Nën këtë iniciative tavolina e rrumbullakët me temë “Rekomandimet për përmirësime në kuadrin ligjor dhe rregullator për peshkimin artizanal dhe argëtues në gjirin e Vlorës” organizuar me 10.06.2021, pranë Qendres së Vizitorëve, Radhime, Vlorë, sherbeu si një hapsirë e lirë diskutimi dhe konsultimi mes ekspertëve, OMP-së Vlorë dhe autoriteve publike përkatëse lokale lidhur me përpilimin e rekomandimeve për mënyrën e menaxhimit të qëndrueshëm të peshkimit në shkallë të vogël, duke i dhënë rëndësi zbatimit me efikasitet të kuadrin ligjor dhe rregullator për peshkimin artizanal dhe argëtues, veçanërisht në afërsi të zonave të mbrojtura të gjirit të Vlorës.

Project partners:



Takimi solli në vëmendje disa nga problematikat që hasin në vazhdimësi peshkatarët artizanal ku mes të tjerave mund të përmendim:

- Peshkimi turistik mund të ishte një alternativë e peshkatarëve për sigurimin e të ardhurave dytësore duke zvogëluar edhe ndikimin e tyre në rezervat detare. Por, mungesa e akteve nënligjore specifike për këtë veprimtari; mungesa e sinjalistikës brenda ZM detare, mbivendosja institucionale për dhënien e dy licensave respektive një për turizmin nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe një tjetër për peshkimin nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, mungesa e database mbi mënyrat se si mund të zhvillohet ky aktivitet, janë disa nga problematikat aktuale me të cilat përballet komuniteti i peshkatarëve në zonë.
- Peshkimi artizanal ndryshe nga ai industrial nuk ka mbështetje nga shteti përse i përket: infrastrukturës; karburantit; rrjetave, etj.
- Peshkimi komercial ose industrial ka portin e vet dhe funksionon në formën e organizatave të menaxhimit të peshkimit, ndërsa në rastin e peshkatarëve artizanal, nuk ka një pikë të grumbullimit të tyre, përvençse në rastet e krijuara vullnetarisht siç është "Shoqata e Peshkatarëve të Përgjegjshëm".
- Peshkimit artizanal nuk i është hequr "koperoli" apo leja për të dalë në det sipas ligjit për detin, pasi monitorimi i tyre bëhet vetëm nga policia kufitare, por kapacitete e policisë kufitare janë shumë të limituara, pasi dalja e peshkatarëve është në orët e para të mëngjesit ku veprojnë më shumë se 50 peshkatarë (me ose pa licensë). Për këtë nevojitet të ketë një monitorim të posaçëm nga inspektoriati i peshkimit në Vlorë.
- Peshkimi argëtues përballet me mungesë të akteve nënligjore, mungesa të infrastukturës në breg; kryerjen e pagesave të taksave në insitucionet shtetërore nga njera anë por edhe mungesën e masave ndihmëse nga shteti ndaj këtij aktiviteti nga ana tjetër.
- Ende ka veprimtari të paligjshme si peshkimi me dinamit.
- Ekspertët shkencorë dhe AdZM Vlorë e shohin të domosdoshme krijimin e një "No Take Zone" jashtë kufijve të ZMD, jo më tepër se 1km², e cila do të shërbejë si një zonë zhvillimi dhe riprodhimi efektiv për rezervën e peshkut në gjithë gjirin e Vlorës.

Opinionet dhe sygjerimet e mbledhura në këtë takim, shërbyen për hartimin e një dokumenti me rekomandime për përmirësime në kuadrin ligjor dhe rregullator për reflektimin e cilave do të advokohet dhe lobohet në vazhdimësi pranë instiucioneve lokale dhe qendrore si dhe do të punohet për ndërtimin e partneriteteve të qëndrueshme bashkëpunuese mes komunitetit të peshkatarëve, autoritetve lokale dhe menaxherëve të ZMD.

Shënim: Ceremonia u zhvillua më 10.06.2021 ora 11:00 tek Qendra e Vizitorëve Radhimë. Takimi ishte i hapur për përfaqësues të mediave kombëtare dhe lokale.

INCA

Email: info@inca-al.org

INCA web: <http://www.inca-al.org/>

Project partners:

